

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MËDITËS, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE			
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	DPHNB	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8654/24
Nr. i Faqeve Br. Stranica	/	Data: Datum:	31.12.24
No. Pages		Date:	
PRISHTINË / A			No. 1

## ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 10 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 dhe Nenit 27 paragrafit 2 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

### RREGULLORE PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E NJOHJES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË INXHINIERËVE TË LËSHUARA JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës për njohjen e licencave profesionale të inxhinierëve të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës, nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) dhe kushtet tjera për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me Ligjin në fuqi.

##### Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën dhe organet e saj si dhe inxhinierët e licencuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët angazhohen në veprimtari profesionale në Republikën e Kosovës.

##### Neni 3 Zbatimi i Rregullores së Odës për licencim

Për çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore zbatohen përshtatshëmish dispozitat e Rregullores së Odës për licencim.

##### Neni 4 Përkufizimet

I. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Personi i licencuar jashtë Republikës së Kosovës** – Personi i cili në një shtet tjetër jashtë Republikës së Kosovës ka të drejtë të ushtroj profesionin e inxhinierit në bazë të kualifikimeve profesionale të arritura.

- 1.2. **Rregullorja e Odës për licencim** – Rregullorja në fuqi për procedurën e licencimit, rilicencimit, mirëmbajtjen, pezullimin dhe revokimin e licencës së inxhinierit të licencuar të Odës.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
3. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

## **KAPITULLI II**

### **E DREJTA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT DHE NJOHJA E LICENCËS**

#### **Neni 5**

#### **E drejta e ushtrimit të profesionit të inxhinierit të licencuar jashtë Republikës së Kosovës**

Personi i licencuar jashtë Republikës së Kosovës ka të drejtë të ushtroj profesionin e inxhinierit në Republikën e Kosovës në bazë të parimit të konfirmuar të reciprocitetit ose në zbatim të marrëveshjes ndërkombëtare, pjesë e së cilës është Republika e Kosovës, apo nëse është i licencuar në një nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

#### **Neni 6**

#### **Njohja e licencës**

1. Para se të angazhohet në veprimtari profesionale në Kosovë, në bazë të kërkesës së inxhinierit, Oda njeh licencën profesionale të inxhinierit të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës.
2. Njohja e licencës profesionale nga Oda sipas paragrafit 1 bëhet për mundësimin e:
  - 2.1. ushtrimit të veprimtarisë profesionale të inxhinierit në mënyrë të vazhdueshme, në të cilin rast inxhinierit posedon lejeqëndrim në Kosovë dhe bëhet anëtar i Odës, apo
  - 2.2. ushtrimit të veprimtarisë profesionale të inxhinierit në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit.
3. Njohja e licencës profesionale të inxhinierit bëhet për kategorinë e licencës të Kategorisë A ose Kategorisë B, siç përcaktohet me Ligjin në fuqi dhe Rregulloren e Odës për licencim.
4. Inxhinierit të cilit i njihet licenca në përputhje me Ligjin në fuqi dhe këtë Rregullore ka të drejtë të përdor titullin “inxhinier i licencuar”.

### **KAPITULLI III PROCEDURA E NJOHJES SË LICENCËS**

#### **Neni 7**

#### **Kompetencat e Komisionit Vlerësues**

Komisioni Vlerësues i përcaktuar me Rregulloren e Odës për licencim është përgjegjës për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për njohjen e licencës profesionale të inxhinierit të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës.

#### **Neni 8**

#### **Kërkesa për njohje të licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme**

1. Kërkesa për njohje të licencës profesionale të inxhinierit të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë profesionale në mënyrë të vazhdueshme, paraqitet nga inxhinieri në formë elektronike, përmes sistemit elektronik.
2. Përmes sistemit, aplikuesi paraqet:
  - 2.1. Pasaportën e vlefshme apo vërtetimin tjetër që dëshmon shtetësinë e aplikuesit;
  - 2.2. Fotografinë personale sipas dimensioneve të përcaktuara;
  - 2.3. Dëshmitë për kualifikim formal që përfshinë diplomën apo dëshmitë tjera ekuivalente të lëshuara nga autoriteti kompetent sipas rregullave të atij shteti, që vërtetojnë përfundimin e suksesshëm të studimeve akademike përkatëse, të arritur kryesisht në atë shtet, përfshirë programin e studimit;
  - 2.4. Dëshmitë për kualifikim profesional që përfshinë, përveç kualifikimit formal, vërtetimin e aftësive të arritura pas arsimimit formal, bazuar në trajnim ose provimin specifik, dhe/ose përvojë profesionale, të vërtetuara nga autoriteti kompetent i një shteti tjetër sipas rregullave të atij shteti;
  - 2.5. Certifikatën e nivelit BI të lëshuar nga autoriteti kompetent, që dëshmon njohurinë e njërës prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës. Certifikata nga ky nën-paragraf mund të zëvendësohet me dëshminë e trajnimit profesional drejt arritjes së kualifikimit formal, të zhvilluar në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, dhe
  - 2.6. Vërtetimin, jo më të vjetër se tre (3) muaj, nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër se aplikuesit nuk i është pezulluar apo revokuar licenca e inxhinierit në shtetin tjetër, si dhe vërtetimin se nuk ka falimentuar. Në rast se autoritetet e shtetit tjetër nuk lëshojnë vërtetime të tilla, atëherë vërtetimet nga ky nën-paragraf mund të zëvendësohen me deklaratë nën betim nga aplikuesi.

## Neni 9

### Kërkesa për njohje të licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit

1. Kërkesa për njohje të licencës profesionale të inxhinierit të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit, paraqitet nga inxhinieri në formë elektronike, përmes sistemit elektronik.
2. Përmes sistemit, aplikuesi paraqet:
  - 2.1. Pasaportën e vlefshme apo vërtetimin tjetër që dëshmon shtetësinë e aplikuesit;
  - 2.2. Fotografinë personale sipas dimensioneve të përcaktuara;
  - 2.3. Dëshmitë për kualifikim formal që përfshinë diplomën apo dëshmitë tjera ekuivalente të lëshuara nga autoriteti kompetent sipas rregullave të atij shteti, që vërtetojnë përfundimin e suksesshëm të studimeve akademike përkatëse, të arritur kryesisht në atë shtet, përfshirë programin e studimit;
  - 2.4. Dëshmitë për kualifikim profesional që përfshinë, përveç kualifikimit formal, vërtetimin e aftësive të arritura pas arsimit formal, bazuar në trajnim ose provimin specifik, dhe/ose përvojë profesionale, të vërtetuara nga autoriteti kompetent i një shteti tjetër sipas rregullave të atij shteti;
  - 2.5. Vërtetimin, jo më të vjetër se tre (3) muaj, nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër se aplikuesit nuk i është pezulluar apo revokuar licenca e inxhinierit në shtetin tjetër, si dhe vërtetimin se nuk ka falimentuar. Në rast se autoritetet e shtetit tjetër nuk lëshojnë vërtetime të tilla, atëherë vërtetimet nga ky nën-paragraf mund të zëvendësohen me deklaratë nën betim nga aplikuesi, dhe
  - 2.6. Dëshminë e sigurimit të përgjegjësisë profesionale në përputhje me Rregulloren përkatëse, që mbulon veprimtarinë profesionale në territorin e Republikës së Kosovës.

## Neni 10

### Dispozitat tjera lidhur me kërkesat

1. Kërkesa dhe dokumentet nga Neni 8 dhe 9 paraqiten në formë të përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Paraqitja e kërkesave është pa pagesë dhe të njëjtat pranohen në sistem elektronik, vetëm nëse nga aplikuesi ofrohen të gjitha të dhënat e kërkuara, si dhe ngarkohen dokumentet përkatëse të kërkuara.

3. Format elektronike të paraqitjes së kërkesave përcaktohen me vendim të Bordit.
4. Me rastin e aplikimit, sistemi elektronik gjeneron një vërtetim që dëshmon pranimin, datën, qëllimin e aplikimit dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura.

### **Neni 11** **Shqyrtimi i kërkesës dhe vendimi**

1. Shqyrtimi i kërkesës për njohje të licencës profesionale të inxhinierit të lëshuar jashtë Republikës së Kosovës bëhet nga Komisioni Vlerësues.
2. Komisioni Vlerësues fillimisht bën shqyrtimin e kompletueshmërisë së kërkesës dhe dokumenteve e paraqitura sipas Nenit 10, në afat prej tridhjetë (30) ditë nga aplikimi. Në rast të ndonjë dokumenti apo informate të munguar në aplikim, Komisioni e njofton palën për paraqitjen e tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor.
3. Në kuptim të paragrafit 2, në rastet kur ngriten dyshime për vërtetësinë e të dhënave ose dokumenteve të paraqitura. Komisioni kërkon nga aplikuesi të paraqes në formë fizike dhe origjinale dokumentin e kontestuar.
4. Pas shqyrtimit fillestar, Komisioni Vlerësues në bazë të të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura vërteton plotësimin e kushteve për licencim të aplikuesit sipas kategorive përkatëse të përcaktuara në paragrafin 3 të Nenit 6, dhe merr vendim për njohje apo refuzim të njohjes së licencës.
5. Në zbatim të paragrafit 4, për kërkesën për njohje të licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme, Komisioni Vlerësues vlerëson përputhshmërinë e kualifikimit formal dhe kualifikimit profesional të ofruar me kualifikimet e kërkuara për licencim të inxhinierit në Republikën e Kosovës sipas kategorive përkatëse, në përputhje me Ligjin në fuqi, Rregulloren e Odës për licencat dhe marrëveshjen ndërkombëtare të zbatueshme.
6. Vendimi nga paragrafi 4 merret jo më larg se tre (3) muaj nga paraqitja e aplikimit apo plotësimit të aplikimit sipas paragrafit 2 dhe 3.
7. Gjatë procedurës së shqyrtimit, Komisioni ka të drejtë të verifikoj vërtetësinë e dokumentit edhe drejtpërdrejtë përmes organit që e ka lëshuar atë.
8. Në rast të mos ofrimit të sqarimeve të nevojshme apo plotësimit të kërkesës sipas udhëzimeve të Komisionit dhe afatit të përcaktuar në paragrafin 2 dhe 3, Komisioni refuzon aplikimin.

9. Afatet për shqyrtimin e kërkesës dhe vendimit nga ky Nen mund të ndryshojnë në rast se përcaktohen ndryshe me marrëveshjen ndërkombëtare, pjesë e të cilës është Republika e Kosovës.

#### **Neni 12**

##### **E drejta në ankesë dhe shqyrtimi i saj**

1. Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues, aplikuesi mund të paraqes ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
2. Ankesa shqyrtohet në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e saj.
3. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

#### **Neni 13**

##### **Vendimi për njohjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme dhe kohëzgjatja**

1. Pas vendimit për plotësimin e kushteve për njohjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme, para se të lëshohet vendimi për njohje të licencës, aplikuesi:
  - 1.1. paguan taksën për njohje të licencës;
  - 1.2. paguan tarifën vjetore për anëtarësim në Odë sipas vlerave të përcaktuara me Rregulloren përkatëse, dhe
  - 1.3. ofron dëshminë e sigurimit të përgjegjësisë profesionale në përputhje me Rregulloren përkatëse.
2. Pas pagesës së taksës për njohje të licencës, tarifës vjetore dhe ofrimit të dëshmisë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale në përputhje me paragrafin 1, aplikuesit i njihet licenca për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme me vlefshmëri pesë (5) vite. Me vendimin për njohje të licencës, inxhinieri të cilit i njihet licenca për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme, bëhet anëtar i Odës.
3. Inxhinieri të cilit i njihet licenca për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme regjistron qëndrimin në Republikën e Kosovës dhe pas pranimit të lejeqëndrimit e njofton për këtë Odën përmes sistemit elektronik.

**Neni 14**  
**Vendimi për njohjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit**

1. Pas vendimit për plotësimin e kushteve për njohjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit, para se të lëshohet vendimi për njohje të licencës, aplikuesi paguan taksën për njohje të licencës në përputhje me Rregulloren përkatëse të Odës për tarifaf.
2. Aplikuesit i njihet licenca për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit me vlefshmëri prej gjashtë (6) muaj. Periudha e vlefshmërisë mund të zgjatet për periudha të vazhdueshme prej gjashtë (6) muaj me kërkesë të aplikuesit dhe pagesën e taksës në përputhje me Rregulloren përkatëse të Odës për tarifaf.
3. Për paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së njohjes së licencës për të ushtruar veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat për paraqitjen e kërkesës për njohjen e licencës. Në këtë rast, aplikuesi nuk ka nevojë të paraqes sërish dokumentet të cilat mbesin të pa ndryshuara dhe valide nga paraqitja e kërkesës paraprake, si dhe të cilat janë në posedim të Odës.

**KAPITULLI IV**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca

  
Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës